



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



| | |
|-------------------------------|--|
| DATË/A: | 29.05.2019 |
| REFERENC-Ë: | 210 / 19 |
| PËR/ZA/TO: | AK – “Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës” OE – “Tetroniks” shpk L.L.C-Prishtinë |
| NGA/OD/FROM: | Nuhi Paçarizi Kryetar i Panelit Shqyrtues-OSHP |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | N J O F T I M |

Operatori Ekonomik: OE - “Tetroniks” shpk L.L.C-Prishtinë si palë e pa kënaqur më datën: 13.05.2019, ka parashtruar ankesë me nr. 210 / 19, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut" me nr. të Prokurimit : 213-19-2534-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - “Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës” duke pretenduar se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së,

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimi të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 15.05.2019, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore të OE – “Tetroniks” shpk L.L.C-Prishtinë

Eksperti i OSHP-së më datën: 17.05.2019, ka dorëzuar raportin me të gjitha sqarimet dhe rekomandimin e tij lidhur me ankesën e lartpërmendur, me ç'rast ka vlerësuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës OE – “Tetroniks” shpk L.L.C-Prishtinë, është e bazuara dhe rrjedhimisht ka rekomanduar panelin shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e OE- ankues dhe për këtë aktivitet të prokurimit të behet përmisimin i dosjes se tenderit dhe te zgjatet afati për dorëzimin e ofertave konform nenit 53.7 të LPP-së.

Me datën: 17.05.2019, Autoriteti Kontraktues: AK - "Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës" si dhe parashtruesi i ankesës: OE- "Tetroniks" shpk L.L.C-Prishtinë e kanë pranuar raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut" me nr. të Prokurimit : 213-19-2534-1-2-1,

Autoriteti kontraktues AK-"Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës"përmes parashtrësës së datës: 20.05.2019, pas pranimit të raportit të ekspertit shqyrtues ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 17.05.2019

Operatori ekonomik: OE : "Tetroniks" shpk L.L.C-Prishtinë përmes parashtrësës së datës: 20.05.2019 ka njoftuar OSHP-në , se **PAJTOHET** me mendimin e dhënë të ekspertit të OSHP-së në raportin e datës: 17.05.2019

Paneli Shqyrtues, njofton OE ankues dhe Autoritetin Kontraktues, se konform nenit 115 pika 3 të LPP-së, procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti Kontraktues: AK- "Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës" lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Avancimi i sistemit të zërimit të ASHAK-ut" me nr. të Prokurimit : 213-19-2534-1-2-1, *të behet përmisimin i dosjes se tenderit dhe te zgjatet afati për dorëzimin e ofertave konform nenit 53.7 të LPP-së* dhe ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues, kërkon nga Autoriteti Kontraktues, zbatimin e rekomandimit të ekspertit shqyrtues, dhe në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik ankues OE – "Tetroniks" shpk L.L.C-Prishtinë konform nenit 118 pika 3 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet OE ankues që konform nenit 33 pika 6 e Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e Panelit Shqyrtues:

z. Nuh Paçarizi _____ Kryetari i Panelit Shqyrtues,

z. Blerim Dina _____ Referues,

z. Goran Milenković _____ Anëtar.